



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:000370
Datë: 17.01.2024
Numri i dokumentit: 05203348

C.nr. 2995/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Besnik Shala - në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.L nga fsh. Ll K.P të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Av. B.L nga P, kundër të paditurës “.....” Sh.p.k. me numër unik identifikues 810413584 dhe me seli në rr. “.....” nr..., Pejë të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.N nga P, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 5,400 euro, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 18.12.2023, ndërsa me datë 17.01.2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesë padia e paditësit D.L nga fsh. Ll K.P, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura E sh.p.k me nr. unik identifikues 810413584 dhe me seli në P në adresë rr.“.....” nr..., që paditësit në emër të zhdëmtimit-kompensimit të dëmit, si pasojë e lëndimeve trupore të pësura në punë me dt.25.09.2021, ti kompensoj shumat, në emër të dëmit jo material: në emër të dhimbjeve fizike-trupore për lëndime të lehta 2,000.00 €, në emër të frikës së përjetuar për lëndime të rënda 2,000.00 €, në emër të dëmit material , shpenzimet për kujdes dhe ndihmën e huaj shumën prej 400 €, shpenzimet për ushqim të përforcuar 600 €, shpenzimet në emër të rehabilitimit fiziko-terapeutik 400 €, të gjitha këto në kamate ligjore prej 8 %, nga dita e parashtrimit të padisë, **në tersi si e pa bazuar.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate me datë 31.12.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës, me bazë juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 5,400 euro, e të precizuar me parashtrësën e datës 02.11.2023.

I autorizuari i paditësit me padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndrojmë në tërësi pranë padisë dhe parashtrësës për precizimin e saj dhe konsiderojmë se nga provat në shkresat e lëndës dhe të administruara nga gjykata, si dhe nxjerrja e provës me ekspertizë nga lëmia e mjekësisë është vërtetuar se paditësi ka pasur lëndime të lehta trupore në boshtin kurrizor nga i cili ka pasur dhimbje fizike të përshkuara si në mendimin e ekspertit të ortopedisë të dhëne me dt. 24.10.2023, pranë kësaj gjykatën, e po ashtu është

vërtetuar se i njëjti ka përjetuar frikë të përshkuara si në mendimin e ekspertit të psikiatrisë i dhëne me dt. 24.10.2023, nga gjendja faktike është vërtetuar qartë nga provat në shkresat e lendes siç janë listat e evidencës në punë për paditësin ku vërtetohet se i njëjti ka punuar me orar të rregullt prej 8 orësh punë, ndërsa nga raportet e spitalit të përgjithshëm të Pejës është vërtetuar se lëndimet e paditësit janë shkaktuar gjatë kohës sa ka qenë në punë me datën e lartcekur, gjithashtu edhe deklarata e paditësit e dhëne në gjykatë me dt. 27.11.2023 në faqen 3, ku nga pyetja e përfaqësueses së të paditurës ishte në sa ora jeni kthyer në P, i njëjti ka deklaruar rreth orës 12-1, ku kjo deklaratë përputhet edhe me kohën e paraqitjes së tij në emergjencë në spitalin e P, ku kishte ardhur nga M në P si i lënduar, po ashtu me përgjigje në Padi e paditura në cilësinë e provës ka dorëzuar edhe një deklaratë të M.B ku të njëjtin e kemi propozuar që të dëgjohet si dëshmitar, por në pamundësi të gjetjes së sa adresës së tij kemi hequr dorë nga ky propozim, por që nga deklarata e tij e dt.24.07.2023, i njëjti e pohon faktin se paditësi ditën e lëndimit ka qenë i ngarkuar në firmat M-V dhe i ka thënë që nuk po ndihet mirë dhe ka dërguar në Spitalin e P në emergjencë ku paditësi është pranuar në orën 13:41, vërtetohet lëndimi paditësit në punë meqenëse nuk ka mundur të përfundoj orarin e rregullt të punës si pasojë e lëndimeve, e në bazë të ligjit në punës nenit 60 lidhur me nenin 6 par.3 të ligjit për sigurinë dhe shëndetit në punë shprehimisht parasheh se " Punë dhënësi i përgjigjet të punësuarit për demet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punë" andaj konsiderojmë se nga gjendja faktike është vërtetuar në raportet mjekësore paditësi është lënduar në punë dhe sipas parimit të përgjegjësisë objektive të punëdhënësit në kuptim të nenit 36 bie në barë të paditurës që të kompensoj dëmin paditësit, si dhe konform nenit 14 par.1 ligjit për siguri dhe shëndet në punë punëdhënësi është i obliguar ti mbajë në gjendje të rregullt dhe të kontrolloj rregullsinë dhe sigurinë e tyre, Sa i përket provave të dorëzuara nga pala e paditur në seancën e dt. 27.11.2023, si e kemi kundërshtuar gjatë seancës, i konsiderojmë si provë të cilat janë dorëzuar në kundërshtim me nenin 406 par 1 lidhur me nenin 428 par.2 të LPK-së, pasi që të njëjta është dashur të dorëzohen më së largu deri në fund të seancës përgatitore, si dhe nuk kanë fuqi provuese dhe nuk e provojë faktin se në lokacionet e cekura në ortofoto kanë qenë ndalesa të paditësit dhe nuk kanë identitet të lëshuesit të këtyre fotove për të treguar faktin se janë nxjerr nga e paditura. Si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar.

E autorizuar e të paditurës në përgjigje në padi gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kontestojmë ne tersi kërkesëpadinë paditësit D.L si dhe precizimin e bere me dt. 02.11.2023, dhe i propozojmë gjykatës te njëjtën ta refuzoj si te pa bazuar. Ne si e paditur asnjëherë deri ne marrjen e ftesës nga ana e gjykatës për përgjigje ne padi nuk jemi vene ne dijeni se paditësi është lënduar në punë dhe se këtë lëndim i njëjti asnjëherë nuk ka parashtruar kërkesë për kompensim te demit material apo jo material me qellim te shtjerrës se mundësisë se brendshme, sipas padisë paditësi lëndimin e ka marrë tek E.C ne M mirëpo padisë nuk i ka bashkangjitura asnjë prove qe do te dëshmonte se me te vërtet është lënduar aty, sepse sipas ligjit për siguri dhe shëndet ne pune, aty ku ndodhe lëndimi aty dhe behet inspektimi pa marre parasysh peshën e lëndimit, po ashtu në padi nuk është bashkangjitur prova raporti i policisë apo i inspektoreve te punës as i rajonit te M e as i P, Ne seancën e dt. 24.10.2023, eksperti i psikiatrisë Dr. M.H ka bere ekzaminimin e drejtpërdrejt te paditësit ku nder te tjera ka deklaruar se pas lëndimit te marre me paletar ka qëndruar rreth 40 minuta pa vetëdije, dhe pasi qe është kthjellur ka vazhdat direkt për ne P, te cilin për me hypur në kamion e ka ndihmuar

punëtorët e E.C ne M, ku me këtë deklaratë paditësi bie ndesh me fjalët e veta se nëse punëtorët e E.C e kanë ndihmuar të njëjtit nuk do të linin 40 minuta pa vetëdije të shtrire, dhe se deklarata ka kontradikta në mes vete është deklarata tjetër që ka dhënë në cilësi të palës me dt. 27.11.2023, ku deklaroi se ka qene pa vetëdije 20-30 minuta , që d.m.th. se prej seancës së dt. 24.10.2023, i njëjti ka ndryshuar deklaratën e tij diku deklaroi se ka qëndruar 40 minuta pa vetëdije e diku deklaroi se 20-30 minuta pa vetëdije. Gjate dëgjimit si pale paditësi po ashtu ka deklaruar se ka pasur lëndime në fytyrë nga thasët e sodës që i kanë rënë, ndërsa në fakt në foton e bashkangjitur kësaj padie vërehet fytyra e tij pas asnjë shenje të vetme si pikëpyetje tjetër mbetet edhe fakti se paditësi a është goditur nga paletari apo nga thasët e sodës, paditësi ka deklaruar se shenjat në fytyrë i ka pasur sa ka qëndruar në spital dhe fotot në shkresë të lëndës kanë qene të mëvonshme pas 2-3 jave, ndërsa deklaratimet para ekspertit të ortopedisë dhe psikiatrisë para gjyqtarit të çështjes si dhe në shkresë të lëndës i njëjti nuk është hospitalizuar asnjë ditë të vetme bazuar në shkresë të lëndës. Nga raporti i GPS të kamionit që ka vozitur paditësi me dt. 25.09.2021, të dorëzuar si provë nga e paditura është gjetur fakti tjetër, i cili dëshmon që paditësi me këtë datë ka shpërndarë të gjithë mallin në pikat të cilat i ka pasur të ngarkuar sipas planit dhe atë si vijon: nisja nga Depo logjistike në fsh. Z është bere në ora 07:05:49, i cili në E.C ka arritur në ora 08:26 minuta ka qëndruar aty deri në ora 08:49 min, pastaj ka vazhduar në QTA në M nga ora 08:52 deri në ora 09:52, pastaj E.T.C E depo nga ora 09:52-10:19 minuta është ndalur tek R.R në ora 10:3 deri në ora 10:46min, ka vazhduar në QTA në ora 10:54 dhe ka vazhduar deri në ora 11:22, ka vazhduar me shpërndarjen e mallit në QTA store 5 në ora 11:29 dhe ka qëndruar deri në ora 11:50, dhe nga aty ka vazhduar në QTA M nga ora 1:55 deri në ora 12:05 minuta që nënkupton se i njëjti ka përfunduar rutat sipas planit dhe është nisur për në Pejë në ora 12:05 minuta, ndërsa në Depon Logjistike në Z ka arritur për 1 orë e 10 minuta përkatësisht në ora 13:15 minuta, Prandaj duke u bazuar në fakte si me lartë paditësi padi që ka dorëzuar mallin tek biznes E ka vazhduar në pikat e tjera sipas punës i cili pas kthimit në Depon në Z ka vazhduar në Spitalin e Përgjithshëm në P ku është paraqitur si i lënduar mirëpo një qëndrim i tillë nuk është i vërtetë për vet faktin se dëshmia e GPS deklaratimit të vet paditësit në këtë seancë e dëshmojnë të kundërtën. Orari i punës për paditësin ka qenë nga ora 06-14:00 andaj duke u bazuar nga të thënat me lartë faktet dhe provat e dorëzuar pranë kësaj gjykate propozojmë që padia të refuzohet si e pa bazuar, Si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: kontrata individuale e punës me nr. Protokollin 1561/2021, aneks kontrata me nr... mbi themelimin e marrëdhënies së punës, raporti i spitalit të përgjithshëm në P-Emergjencja për D L, udhëzimi për hulumtime diagnostike për D.L, raporti nga konsulta për D.L, CT e kurrizit e dt. 25.09.2021, dy foto të formatit A4 të paditësit D.L, deklarata e M.B e dhënë me dt. 24.07.2023, kartela e punëtorëve 2021 për D.L, sigurimi shëndetësor kategoria IV nga S, aneks kontrata me nr. Ref: 002/01-2019 në mes të E sh.p.k dhe S, kontrata për sigurim shëndetësor me nr. Ref: 002/01-2019, 7-foto të GPS-it të lokacioneve, raporti i ndalesave i dt. 25.09.2021, pasqyra e dokumenteve për Transport, ekspertizat nga lamia e Ortopedisë dhe Psikiatrisë, deklaratën e paditësit D.L,

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mesë Në mesë palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se pala paditëse ishte i punësuar tek e paditura sipas kontratës së punës 1561/2021 të datës 01.04.2021, e cila ishte bashkangjitur në shkresa të lendes si provë.

Në mesë palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se pala paditëse me datë 25.09.2021 ishte paraqitur ne emergjencën e Spitalit të P dhe kishte kërkuar ndihmë mjekësore për lëndime.

Kontestuese mes palëve ishte fakti se lëndimet e paditësit të cilat i njëjti i kishte pësuar, a ishin shkaktuar gjatë punës së tij apo jo.

Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse kishte ber marrjen e provës me ekspertizë nga lamia e Ortopedisë dhe Psikiatrisë ku ekspertet në seancën e datës 24.10.2023, pas ekzaminimit të paditësit D.L në prezencën e gjykatës kishin konstatuar se: Eksperti nga lamia e Ortopedisë Dr. F.B kishte deklaruar në baze të dokumentacionit mjekësor që posedon në shkresa të lendes së gjykatës kemi të bëjmë me një ndrydhje të pjesës se poshtme të boshtit kurrizor, po ashtu dyshimi fillestar ka qene për një frakturë të unazës së pare të pjesës lumbasle të boshtit kurrizor, dyshim i cili është hequr në incizimin e thellë CT, dhe interpretimin nga ana e radiologut i cili në këtë rast është kompetent dhe i thirrur për interpretim të imazherisë. Pas eliminimit të frakturës: Natyra e lëndimit-lëndim i lehte trupor, Diagnoza-ndrydhje e pjesës torakolumbal të boshtit kurrizor. Dhembjet fizike - të intensitet shume të larte ka pasur deri në 1 orë. Dhimbje të intensitetit të larte ka pasur deri në 4 orë. Dhembje të intensitetit të mesëm ka pasur 4 javë. Dhembje të intensitetit të ulët deri në 6 muaj. Shëmtim trupor nuk ka. Ndihma dhe perkujdesi i huaj ka qene i nevojshëm për 4 javë. Ushqimi i përforcuar 6 javë. Terapi fizikale ka pasur nevoje për se paku dy here në vit, nga 10 ditë për dy vitet e para. Zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor në baze të shkresave të lendes dhe diagnozave të lartcekura nuk ka. Eksperti nga lamia e Psikiatrisë Dr. M.H kishte deklaruar ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 4 orësh, të manifestuar me dominim të sistemit nervor autonom (të rrahura të shpejtuar të zemrës, dridhje të muskujve, frymëmarrje të vështirësuar dhe ankesa të tjera trupore). Frike sekondare me intensitet të mesëm ka pasur në periudhën kohore gjer në 4 javë të manifestuar me një çrregullim të stabilitetit psiko-fizik si pasojë e lëndimit si: pengesa të here pas hershme në gjumë, rikujtim të ngjarjes traumatike, kufizim të pjesërishëm në aktivitete e përditshme jetësore, shkalle me të ulet të tolerancës frustrative dhe ankesa të tjera trupore. Frike sekondare me intensitet të ulet ka pasur në periudhen kohore gjer në 3 muaj, e që është manifestuar gjate kohës kur ka kaluar ka vendi i ngjarjes apo ngjarjet që ia rikujtojnë lëndimin.

Gjykata i fali besimin mendimit dhe konstatimit të ekspertëve pasi që të njëjtat ishin në harmoni njëra me tjetrën dhe në përputhshmëri me provat të cilat gjenden në shkresat e lendes, edhe pse pala e paditur e kundërshton të njëjtën mendim nga ana e ekspertëve ku në seancën e datës 27.11.2023 kishte deklaruar se e kundërshtoj ekspertizën por nuk propozoj ekspertizë të re.

Sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse gjykata ka ber dëgjimin e paditësit në cilësinë e palës në seancën e datës 27.11.2023, ku i njëjti ka deklaruar se: kam shkuar tek marketë Emona në Mitrovicë, dhe aty kam dalur të zhgarkoj një palët me detergjent, dhe unë kam kapur paletarin kam menduar se është i njëjti si çdo dite, po atë dite fati ka dashtë që atë paletar që ma kane vendosur personat përgjegjës, kur kam ardhur deri të dalja apo leshumja e paletes nuk ka funksionuar komanda lëshuese e paletarit dhe detergjenti apo paleta me ka godit dhe me ka gjuajt me shpine për tretuar, aty ka qene edhe e ndaluar ndalja për shkarkimin e mallrave, dhe aty kam pësuar lëndim. Ne pyetjen e gjykatës se ne atë moment a të kane dërguar në spital punëtorët që kane qene prezent? jo sepse aty ka qene e ndaluar parkingu i kamionit, ku aty kam qëndruar diku rreth 20-30 minuta dhe ata punëtor të E me kane dërguar në kamion duke me ndihmuar që të hypi në kamion nga aty direkt kam ardhur në Pejë në gjendje të mjerueshme në depon në Z, dhe aty kur kam ardhur nuk kam mundur të zbres nga kamioni dhe me ka ndihmuar M.B dhe një sigurim që ka qene tek rampa. Dhe nga aty para duarve me kane hyp në pikap dhe me kane dërguar ne emergjence. Ne momentin kur kamë filluar ngritjen e paletës kamë qene brenda në kamion dhe kam ren, nga pjesa e prapme qe është rampa-ibobina. Ku punën kam filluar ora 07:30 dhe në Pejë jam kthyer diku rreth orës 12-1 nuk e di saktësisht pasi qe nuk kam qene në gjendje te mire shëndetësorë. E autorizara e të paditurës në pyetjen,, A keni kërkuar ndihme nga punëtorët e E pasi qe gjendja juaj ka qen e rende sipas jush? nuk me kujtohet saktësisht për shkak te lëndimit nga hazi i madh i goditjes se paletës, por aty janë afuar punëtorët. Në pyetjen e të autorizuarës te paditurës A është vërtetë qe nuk keni dërguar mallra diku tjetër përpos E ditën kritike, kur jeni lënduar? nuk kam dërguar diku tjetër përpos te E, 100%, edhe pse kam pasur ne kamion pika te tjera për te i dërguar mirëpo kam ardhur direkt në depo.

Gjykata nuk i fali besimin deklaratës së palës paditëse të dhen në seancën e datës 27.11.2023, pasi që e njëjta ishte në kundërshtim edhe me provat tjera ku pala paditëse kishte deklaruar se pas lëndimit të pësuar në M kishte ardhur menjëherë në P, mirëpo lidhur me këtë deklaram pala e paditur kishte paraqitur prova siç është ortofoto e GPS me anë të cilave vërtetohet fakti se paditësi ditën kritike kishte vizituar edhe marketet tjera të cilat i kishte të parapara ti vizitonte at dit dhe pas përfundimit të vizitave ishte kthyer në Pejë, për çka edhe ky fakt e bën jo bindes deklaratën e të njëjtit

Gjykata e shqyrtoj deklaratën me shkrim të dhënë nga M.B të datës 24.07.2023, mirëpo e njëjta nuk i referohet se paditësi ka pësuar lëndim por vetëm se nuk po ndihet mirë dhe që e ka dërguar në spital, gjykata lidhur me këtë deklaratë ka aprovuar propozimin e palës paditëse për dëgjimin e të njëjtit në cilësi të dëshmitarit mirëpo në seancën e datës 27.11.2023, pala paditëse është tërhequr nga propozimi që i njëjti të dëgjohet për çka dhe gjykata mbi bazën e kësaj deklarate nuk mund të konstatoj faktin se paditësi ka pësuar lëndim në vendin e punës apo jo.

Gjykata duke pasur parasysh në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë raport të policisë, për të përshkruar incidentin e ndodhur, raport të inspektoratit komunal/të punës, me të cilin do të krijohet një pasqyrë mbi faktet që do të ishin të rëndësishme për incidentin siç janë nëse ditën kritike nuk ka funksionuar mekanizmi i paletarit për tërheqjen e paletës me detergjent ku dhe si pasoj e kësaj siç pretendon paditësi ka pësuar lëndimi duke e goditur në gjoks, dhe nëse e paditura

ka pasur ndonjë lëshim me të cilin është kontribuar në shkaktimin e incidentit, po ashtu nuk është bërë sigurimi i marrjes së provës menjëherë pas ndodhjes së incidentit, siç përcaktohet me nenin 379, 380, 381, 382, 282, 384 dhe 385 të LPK-së, ndërsa pas ndryshimit të gjendjes faktike, e ku siç ka deklaruar edhe vet pala paditëse se pas lëndimit ka vozitur nga qyteti i Mitrovicës deri në Pejë dhe pastaj ka shkuar në Emergjencën e Spitalit të Pejës. Ku ky fakt nuk është kontestues nga deklaratimet e palëve, si dhe nga shkresat e lëndës se paditësi ka shkuar në Emergjencë, por është e pa mundur të jepet një mendim objektiv nga cili do ekspert, lidhur me rrethanat e ndodhjes së incidentit dhe vërtetimin e përgjegjësisë së të paditurës në shkaktimin e dëmit. Pasi që me nenin 60 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: “ Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t’ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme ”.

Me nenin 42 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe 6 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: “ 1. I punësuar ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës. 2. Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin. 3. Punëdhënësi detyrohet ta informojë punëtorin me shkrim para angazhimit të tij, për rreziqet në punë dhe për masat mbrojtëse të cilat obligohet t’i marrë. 4. Punëdhënësi obligohet të japë udhëzime që tregojnë rreziqet në punë dhe masat mbrojtëse të cilat duhet të merren në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. 5. Punëdhënësi është i detyruar t’i zbatojë rregullat dhe procedurat e përgjithshme për mbrojtjen dhe sigurinë në punë, që janë të përcaktuara me Ligjin për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Mbrojtjen e Ambientit të Punës. 6. I punësuar është i detyruar t’i përmbahet rregullave për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në mënyrë që mos të rrezikojë shëndetin dhe sigurinë e vet, si dhe sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve të tjerë ”.

Me nenin 154 të LMD-së, përcakton se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij ”, me nenin 158 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 192 paragraf 1, përcaktohet se: “ I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh nga sa do të ishte ka të drejtë vetëm për kompensim përpjesëtimisht të pakësuar ”.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe nga vlerësimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës sipas vlerësimit të Gjykatës kërkesëpadia e paditësi është në tërësi e pabazuar.

Përveç të cekurave në këtë rast baza juridike e kërkesëpadisë nuk gjen mbështetje në nenin 154 dhe 158 të LMD-së, për arsye se: Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai

është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e nenit 154 të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t'ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm c) të ekzistojë faji i dëmtuesit d) që të ekzistojë aftësia delikatore dhe e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në këtë rast nuk janë plotësuar këto parakushte ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e të paditurës, për kompensimin e dëmit, paditësit pasi që nuk është vërtetuar me asnjë provë se paditësi lëndimet e pësuar i ka pësuar gjatë orarit të punës siç pretendon i njëjti.

Sipas vlerësimit të Gjykatës paditësi në këtë rast nuk ka arritur ti vërtetojë faktet mbi të cilat e mbështet kërkesën e vet edhe pse kjo ka qenë detyrë e tij, në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 dhe 2, e lidhur me neni 7 paragrafi 1 dhe 319 paragrafi 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Gjykata është e autorizuar ti vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuara në nenin 3 paragraf 3 të këtij ligji) në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe”.

Për të pasur sukses në kërkesëpadinë, pala paditëse është dashur që të argumentoi faktet mbi të cilat e mbështet kërkesën e vet, mirëpo paditësi nuk ka arritur të argumentojnë bazën e kërkesëpadisë duke ber lidhjen kauzale se me lëshimet e palës së paditu ka ardhur deri të incidenti ku siç theksuam edhe më lartë i nijeti ka pasur mundësi që të njoftoj organet kompetente ku do të përpilohet ndonjë raport i policisë, për të përshkruar incidentin e ndodhur, raport të inspektoratit komunal/të punës, apo edhe të kërkoj sigurim prove ku asnjërin nga këto veprime paditësi nuk i ka ndërmar në atë mënyrë që të vërtetohet fakti se i njëjti lëndimet e pësuar në ditën kritike i ka pësuar në vendin e punës. Në këtë kontekst pretendimi i palës paditëse se në këtë rast i takon e drejta për të kërkuar kompensimin e dëmit, nga e paditura, si i tillë është i pabazuar, për arsye se në mungesë të provave nuk mund të vërtetohet lidhja kauzale për çka Gjykata, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e pabazuar.

Gjykata i shqyrtoj me kujdes edhe provat tjera të cilat ishin në shkresa të lendes mirëpo të njëjtat ishin pa ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje juridiko civile

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452, 463.1 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë pasi paditësi i ka kërkuar shpenzimet dhe i ka specifikuar mirëpo i njëjta ka humbur kontestin, edhe pse paditura i ka kërkuar shpenzimet dhe i ka specifikuar sipas tarifës së OAK-së mirëpo e njëjta nuk është avokate për çka nuk i takojnë shpenzimet sipas kësaj tarife për çka edhe gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:000370 - C.nr. 2995/21, 17.01.2024**

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.